



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:219985

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05691438

**C.nr.198/17**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri duke vendosur në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës” (magjistrалja Prishtinë-Fushë Kosovë), kundër të paditurit E. S. nga fshati L., Komuna e Malishevës, me objekt kontesti “Për rimbursim të dëmit material”, vlera e kontestit 240.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 16.05.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **HEDHET POSHTË si e palejueshme** padia me numër C.nr.198/17 e datës 19.06.2017, e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), e paraqitur kundër të paditurit E. S., me objekt kontesti për rimbursim të dëmit material, për shkak se çështja është gjë e gjykuar (res iudicata), me aktgjykimin me numër C.nr.158/17 të datës 22.03.2019.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, me datë 19.06.2017, në këtë gjykatë ka parashtruar padë ndaj të paditurit E.S. nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, me objekt kontesti “Rimbursim i dëmit material”, vlera e kontestit 240.00 euro.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së palës paditëse, gjatë shqyrtimit paraprak të të njëjtës dhe duke u përkujdesur sipas detyrës zyrtare, nga shikimi në shkresat e lëndës ka konstatuar se çështja në fjalë më herët është gjykuar (res iudicata), dhe se për këtë çështje dhe ndërmjet këtyre palëve, tani më është vendosur nga ana e kësaj gjykate.

Deri te konstatimi i tillë, gjykata erdhi pasi bëri vlerësimin e aktgjykimit të marrë nga kjo gjykatë të datës 22.03.2019 me shenjen C.nr.158/17, i plotfuqishëm me datë 17.04.2019 dhe i ekzekutueshëm me datë 03.05.2019. Nga ky vendim konstatohet se i njëjti është marrë në çështjen kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), kundër të paditurit E.S., aktgjykim i cili objekt të çështjes kishte rimbursimin e dëmit material, me vlerë të kontestit 240.00 euro.

Siç dihet, pas pranimit të padisë, gjykata duhet bërë shqyrtimin paraprak të saj, dhe nëse gjatë shqyrtimit paraprak konstaton se për çështjen e ngritur me padi çështja është gjë e gjykuar (res iudicata), atëherë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme, kjo është paraparë edhe me nenin 391 pika d) ku parashihet se: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”*.

Duke u ndodhur në një situatë të tillë, dhe pas konstatimit se në po të njëjtën gjykatë, objekti i lëndës C.nr.198/17 i datës 19.06.2017 është gjykuar në lëndën C.nr.158/17, pra meqenëse të dyja çështjet paraqesin objektin e njëjtë, palët e njëjta dhe periudhën e njëjtë kohore, gjykata vlerëson se nuk mund të hyjë ta shqyrtojë çështjen, dhe këtë padi e ka hedhur si të palejueshme duke u bazuar në nenin 391 pika d) të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 166 par.2 lidhur me nenin 391 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.198/17, datë 16.05.2024**

**Gjyqtari**  
**Petrit Curri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.